



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 368/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019 në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pasafatshme ankesa Anr.368/2017, i datës 09.10.2019, parashtruar nga e koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet: KQZ që të bëjë rinumërimin e votave në nivel vendi.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.10.2019, parashtruar nga subjekti politik-koalicioni NISMA-AKR-PD me seli në Prishtinë, për shkak të gabimit teknik që i referohet mungesën së katrorëve në një kolonë në Formularin e Përputhjes së Rezultatave, ku si rezultat i këtij gabimi teknik është dëmtuar rëndë procesi zgjedhor, andaj duhet të urdhërohet KQZ-ja që të bëjë rinumërimin e votave në nivel vendi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërin e ankesës, gjeti se :

Ankesa është e pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që i referohen, ditës së votimit e në këtë rast gabimi teknik të cilit i referohet ankuesi, ka të bëjë me parregullsiën ditën e votimit, pasi atë ditë nga komisionerët është vërejtur gabimi, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit dhe se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së ku përcaktohet se ” *Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i, do të vendosë për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa*”, si dhe neni 5 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: “*Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit*

parashtrihen pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”.

Në rastin konkret ankesa është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 09.10.2019, dhe se nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërlidhen me procesin e votimit.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesës ka qenë me datën 07.10.2019 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e tij e ka parashtruar në PZAP me datë 09.10.2019, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 të Rregullorës Nr. 02/2015, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Meqenëse ankesa është e pasafatëshme Paneli nuk i shqyrtoi pretendimet tjera ankimore, pasi nuk u lëshua në vendosjen meritore në raport me këto pretendime,

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 368/2019 më datën 10.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së